## Vaj Kokosi

200gr 100gr

Coconut Oil

Vaji i kokosit është një vaj i shkëlqyer për masazh.Vepron si nje hidratant efektiv për të gjitha llojet e lëkurës.Vaji i kokosit përdoret si përbëres bazë për shumë produkte si sapunë,locione dhe kremra që përdoren për kujdesin ndaj lëkurës.Gjithashtu vaji i kokosit ndihmon në ngadalësimin e procesit të plakjes për shkak të vetive të tij të njohura antioksiduese.

Vaji i kokosit është shumë i efektshëm për të rënë në peshë. Ai përmban acide yndyrore që ndihmon në eliminimin e peshës së tepërt.

Vaji i kokosit përdoret si pastrues dhe hidratues për lëkurën. Është i mirë për përdorim të gjithanshëm, anti-bakterial, anti-mikrobial dhe anti-fungal. Ai redukton inflamacionin dhe mban lëkurën të butë.

Në saj të vetive të tij anti-bakteriale, ai ndihmon në shërimin dhe balancon prodhimin e tepërt të yndyrës.

## Gjalpë Shea

200gr

Shea Butter

Gjalpi Shea mbron lëkurën nga dielli dhe dehidratimi. Për mijëra vite, njerëzit e kanë përdorur atë për të mbrojtur lëkurën e tyre nga tharjet, erërat dhe dielli, si dhe për të shëruar shumë probleme të epidermës, carje të vogla dhe djegie. Gjalpi Shea është një yndyrë e bardhë e nxjerrë nga arra e pemës afrikane Shea (Vitellaria paradoxa). Ai përdoret gjerësisht në kozmetikë si hidratues, balsam ose locion. Ekstrakti i gjalpit Shea përmban acide yndyrore si acid stearik, acid palmitik, acid linolenic dhe acid arachidonic. Mbretëresha egjiptiane Nefertiti, e cila ishte e madhërishme dhe e bukur, u tha se borxh bukurinë e saj legjendare e ka prej përdorimit të Gjalpit Shea.

Përfitimet nga Gjalpi Shea:

Riparimin për rrudhat; Antioksidantë; Anti-inflamator; Hidratues i thellë; Stimuluese për qarkullim sipërfaqësor; Forcimin e lëkurës; Mbrojtje e lëkurës; Mbrojtje nga dielli; Rigjenerues për lëkurën; Stimuluese në prodhimin e kolagjenit; Djegiet; Shërim të muskujve; Jep energji; Pickimet nga insektet; Ekzema dhe psoriazis

Gjalpi Shea eshte produkt kozmetik, nuk rekomandohet të perdoret për gatim

## Gjalpë Kakao

100gr

Cocoa Butter

Gjalpi Kakaos është një zbutës i pastër natyror dhe i nxjerrë direkt nga bima e kakaos. Gjalpi i kakaos i jep lëkurës ndjesi të butë për të ndihmuar parandalimin e shenjave që krijohen gjatë rënies dhe shtimit të peshës, duke e bërë lëkurën të ketë elasticitet dhe shkëlqim. Rekomandohet për masazhin e gjirit, për gratë shtatzëna dhe nënat me gji.Gjalpi i kakaos përdoret pas dushit në bërryla, këmbë, duar dhe kudo që ju dëshironi lëkurë të butë. Pas disa ditësh përdorim do të ndieni rezultat të menjëhershëm.

Gjithashtu gjalpi i kakaos ka veti antioksiduese për shkak të tocopherols, si dhe polifenoleve të cilat luftojnë radikalet e lira duke zbutur acarimin e lëkurës. Gjalpi i kakaos është ideal edhe për përdorime të ndryshme në kuzhinë, nuk përmban kolesterol sepse është vegjetal.

# Vajra Bimorë

*Vajrat tona, të përftuara nga bimë dhe fara të ndryshme , kanë dhënë rezultate të mira në kurimin e disa sëmundjeve. Këto vajra bimore janë të pasura me shumë lëndë ushqyese dhe kuruese dhe në sajë të përbërjes së tyre kanë specifika te vecanta në trajtimin e sëmundjeve. Vajrat bimore kanë gjetur një përdorim të gjerë edhe në kozmetikë për trajtimin e të gjitha problemeve të lëkurës dhe organizmit. Aromaterapia është njëra ndër fushat më të popullarizuara të mjekësisë tradicionale dhe është e pranishme në shumë kultura. Këto vajra kuruese kombinohen edhe për: relaks, freski, tonifikim, shërim të plagëve, bukuri lëkure, hidratim, smaliatura etj.*

N. N sh.p.k Autostrada: Tiranë- Durrës, Km 7, Yrshek, Postal Code: 1000, Tirana, Albania
Tel: +355 42 406 500/ 501; Fax: +355 48 200 419; neranxi@neranxi.al; www.neranxi.al

## Vaj Bajame

Almond Oil

100ml

I pasur me vitamina të grupit B dhe minerale si kalciumi, fosofori, potasi, magnezi e hekuri, ai ndikon pozitivisht në shëndet. Për shkak të efekteve të tij lubrifikuese, ai favorizon aktivitetin e zorrëve.Është i pasur me proteina dhe kjo bën që të gjejë përdorim edhe në dietat vegjetariane. Ai u jep shkëlqim e gjallëri flokëve dhe thonjve, është i përsosur për parandalimin e shenjave të zgjerimit të lëkurës (zmaljaturat) sidomos gjatë periudhës së shtatzënisë. Ky vaj mund të përdoret edhe për të pastruar makeup-in. Mund ta përdorni në të gjithë fytyrën, për sytë madje edhe për te hequr rimelin kundra ujit. Lyeni një tampon pambuku dhe pastroni butësisht lëkurën. Ka një efekt në reduktimin e rrathëve të zinj, qeskave apo syve të fryrë. Aplikojeni çdo natë para se të flini. Ndihmon në reduktimin e shenjave të moshës si rrudhat e fytyrës. Ky vaj rinovon qelizat e lëkurës duke ju dhënë një pamje me të freskët e të re. Vaji i bajames ka edhe veti shëruese ne kurimin e ekzemave, skuqjes, inflamacioneve apo çrregullimeve të tjera të lëkurës.

## Vaj Arre

Walnut Oil

100ml

Vaji i Arrës është i pasur me Omega 3, i pasur me vitamina B1, B2, B3 si dhe me vitaminë E dhe vitaminë C. Ul kolesterolin, redukton nivelin e triglicerideve. I pasur me selenium, fosfor, magnez, zink, hekur dhe kalcium. Ndihmon në parandalimin e tumoreve malinje. Përdoret direkt mbi sallata të ndryshme, peshk apo mish në zgarë . Nuk rekomandohet për skuqje. Ai ka veti antihelmetike (lufton shiritin dhe krimbat që parazitojnë në zorrë). Vaji i arrës përdoret me sukses për kurimin e kallove limvadeniteve, tiroideve dhe apceseve, madje edhe atyre kronike. Për këtë qëllim vaji merret nga goja, ndërsa për semundjet e lëkurës përdoret nga jashtë. Me vaj arre kurohen të gjitha plagët që mbledhin qelb. Ka efekt shumë pozitiv kundër rrudhave.Ka përmbajtje antibakteriale dhe ntiinflamatore. Ka shije delikate dhe aromë të këndshme.

## Vaj Argani

Argan Oil

20 ml

100ml

Perdorimi: Fytyrë: hidhni një pikë në mëngjes dhe një në darkë për të luftuar formimin e rrudhave dhe ngadalësimin e procesit të plakjes qelizore. Buzë: mund të përdoret për skrab për rigjenerimin lëkurës së buzëve. Mjafton të përzieni një lugë vaj argani dhe pak sheqer. Flokë: i përshtatshëm për flokë të brishtë, të thatë, të hollë, pa shkëlqim dhe që nuk rriten. Lufton formimin e dy kokave, mjafton të hidhni disa pika mbi duar dhe ta aplikoni me kujdes mbi flokë. Mbajeni një orë më pas lajeni kokën siç bëni gjithmonë.Ai permban vitaminë E në sasi të mëdha, tre herë më shumë se vaji i ullirit. I pasur me vitaminë A; acide yndyrore esenciale Omega 3 dhe Omega 6 rigjeneruese e antinflamatore; polifenole kundër rrudhave.

## Vaj Lini

Linseed Oil

100ml

Vaji i Linit është rezerva më e pasur natyrore me Omega-3 (acid yndyror linolenik) përmban 54-58%. gjithashtu edhe rreth 15-16% Omega-6 (acid yndyror linoleik) Omega-3 dhe Omega-6 quhen ndryshe Vitamina F. Përmban edhe sasi të mira të vitamines E (17.5 mg/100 g) dhe lecitine. Përmban edhe Vit. B1, B2, proteina, minerale etj. Ndihmon për të eliminuar toksinat nga organizmi. Lubrifikon enet e gjakut dhe indet e trupit. Vaji i Linit jep energji dhe përmireson punën e stomakut dhe të zorrëve, në të gjitha moshat. Jep humor të mirë dhe qetësi.
Është esencial për forcimin e sistemit imunitar dhe për ekuilibrimin hormonal. Acidet yndyrore Omega-3 përcaktojnë zvogëlimin e masave tumorale.

## Vaj Kanelle

Cinnamon Oil

100ml

Ndihmon sistemin tretes. Antispazmatik dhe antiseptik. Vetitë: Tkurr mishin e huaj në hunde; Forcon nervin e dëgjimit; Ul kolesterolin; Ndihmon në trajtimin e kancerit cervikal; Parandalon rënien e flokëve dhe stimulon rritjen e tyre.
Trajton infeksionet e skalpit
Përdorimi: Thithet avulli nga hunda 2 herë në ditë, për 10-15 ditë me radhë.
Kjo përthan mishin e huaj në hundë. Në çaj hidhen 2-3 pika për cdo gotë, pihen 2 gota në ditë për 15 ditë rresht. Për shëndetin e flokëve përdoret në formën e maskave. Për ata që vuajnë nga migrena, këshillohet masazh me vaj kanelle për të lehtësuar dhimbjen. Në kulinari përdoret si aromatizues për gatime të ndryshme sidomos për ëmbëlsira. Edhe se vaji i kanellës ka veti të mira shëndetësore mund të japi alergji ose irritime lëkure.

## Vaj Kastori

Castor Oil

100ml

Vaji i Kastori nxirret nga fara (Ricinus communis). Ky është një vaj anti-inflamator dhe anti-oksidant, është përdorur për shekuj me radhë për përfitimet e tij terapeutike dhe medicinale.Ka përqendrim të lartë të acideve yndyrore . Edhe pse ai ka një shije të fortë dhe mjaft të pakëndshme është shumë i ushqyeshëm. Studimet kanë treguar se Vaji i Kastorit është një pastrues shumë i fortë i zorrëve, që e bën atë shumë të efektshm kundër kapsllëkut. Prandaj, thjesht merrni një lugë çaji me Vaj Kastori dhe pijeni në mëngjes për 3 ditë rrjesht. Studimet e suksesshme kanë miratuar përdorimin e Vajit të Kastori për infeksionet e lëkurës dhe probleme të tjera të saj si djegiet nga dielli, pucërrat, lëkurë të thatë, lythat, kruarje dhe sëmundjet kronike të lëkurës.Merrni një pjesë pambuku me vaj Kastori dhe aplikojnë atë në lëkurë, në mëngjes dhe në mbrëmje. Doza tipike e rekomanduar për të kosumuar Vajin e Kastorit është një lug çaji në ditë dhe jo më shumë se 5 ditë rrjesht.
Vaji i Kastorit nuk lejohet të përdoret nga fëmijet nën moshën 12 vjeç dhe gratë shtatzëna.

## Vaj i Farave të Kërpit

Hemp Seed Oil

100ml

Farat e kërpit janë shumë të pasura me acide esenciale yndyrore, proteina, karotinë, antioksidues dhe minerale të shumta, duke përfshirë kalciumin, magnezin dhe zinkun. Për shkak të tyre, vaji i kërpit e ka marrë epitetin e pastruesit më të mirë të organizmit. Ai e mënjanon ujin e tepërt nga trupi, ndihmon në rregullimin e peshës trupore dhe ka efekt shërues në lëkurë, flokë dhe thonj. Një vaj i tillë ndikon pozitivisht në forcimin e sistemit imunitar të njeriut, në funksionin riprodhues të njeriut, në uljen e kolesterolit në gjak, lufton me pllakëzat e yndyrnave në enët e gjakut. Nëse dëshironi që të mbeteni në formë ose të forconi flokët dhe thonjtë, mjafton një lugë e vogël me vaj kërpi në ditë, qoftë duke e përdorur në sallatë, ushqime të tjera ose duke e pirë atë.

## Vaj i Farave të Kajsisë

Apricot Seed Oil

100ml

Vaji i farave të kajsisë absorbohet shumë lehtë nga lëkura, hidraton, rigjeneron dhe mbron lëkurat e ndjeshme apo të plakura. Rinon lëkurën. Përmban acide yndyrore esenciale, të cilat janë burime të pasura të acidit oleik, acidit linoleik, vitaminës A dhe vitaminës E, duke e bërë këtë vaj ideal për kujdesin ndaj lëkurës. Si një burim i pasur me minerale dhe me elementë si kalçium, magnez dhe selen, mban në mënyrë të veçantë lëkurat e thata dhe i jep një pamje të freskët e të shëndetshme. Përdoret në mjekësinë tradicionale kineze për të mjekuar sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes si kolla, astma dhe bronshit. Në industrinë ushqimore përdoret për të prodhuar ëmbëlsira të ngjashme. Përdoret në produktet e garniturës dhe në përzierjet vajore për skuqje. Është gjërësisht i përdorur në programet dietike.

## Vaj i Farës së Zezë

Nigella Sativa Oil

100ml

Ekstrakti I farës së zezë (Nigella Sativa) ka përdorim të gjerë në trajtimin e dhimbjes së kokës, dhimbje dhëmbi, kongjestionit të hundës dhe lamjes. Ajo gjithashtu përdoret për xhepat e infeksionit (abscese), arazitët,për trajtimin e sëmundjeve të traktit duke përfshirë gazrat, dhimbje barku, diarre, dizanteri, kapsllëk dhe hemorroidesi dhe ndihmon tretjen e ushqimit. Ky ekstrakt është përdorur edhe për problemet e frymëmarrjes, duke përfshirë alergji, astma, kollë, bronkit, emfizemë, dhe grip. Përdorime të tjera përfshijnë uljen e presionit të gjakut, uljen e niveleve të kolesterolit, trajtimin e kancerit, dhe rritjen e sistemit imunitar. Mund të aplikohet direkt në lëkurë për dhimbje të kyçeve (reumatizma), dhimbje koke, dhe probleme të lëkurës.

## Vaj Avokado

Avocado Oil

100ml

Vaji i avokados klasifikohet si një vaj bimor. Është një vaj vërtet i pasur me vitamina A dhe D, lecithin, kalium si dhe vitaminën E. Vaji i avokados ka në përbërjen e tij klorofil dhe klasifikohet në vajrat mono-elemental. Vaji i avokados ngadalëson procesin e plakjes dhe formimin e parakohshëm të rrudhave. Është ideal për lëkurat në moshë të madhe, largon thatësinë e lëkurës, por edhe kruarjet që vijnë nga ekzemat apo aknet. Mund të bëhen përzierje të vajit të avokados, jojobës, si dhe vitaminës E, që merret nga vaji i bajames. Kjo lloj përzierjeje ushqen lëkurën e fytyrës dhe të trupit, ndihmon qarkullimin e gjakut, në mënyrë stimuluese ndikon në rritjen e indeve dhe qelizave duke rritur forcën e tyre. Përmirëson rezistencën dhe vitalitetin e saj natyror. Ky vaj e mban lëkurën të re, elastike, të fortë dhe në të njëjtën kohë e bën atë të butë, dhe të shndritshme.

## Vaj Jojoba *Kozmetik*

Jojoba Cosmetic Oil

100ml

Vaj jojoba është një pastrues shumë i efektshem,hidratues dhe zbutës i lëkurës dhe flokëve.Aplikohet direkt në lëkurë për të reduktuar rrudhat. Mund të hollohet për të shëruar shenjat e plagëve,për të pasur skalp dhe flokë të shëndetshëm. Përdorimet e mundshme terapeutike me vaj jojoba përfshijnë trajtimin e puerrave,plagëve dhe sëmundje si psoriaza e lëkurës. Vaji i Jojobës është jo-alergjik dhe nuk i bllokon poret.Rivendos balancën në lëkurën tuaj,duke rikthyer hidratimin,ndarjen dhe rritjen e qelizave në shtresën e mesme të epidermës, ekuilibron nxjerrjen e sebumit dhe normalizon heqjen e qelizave të vdekura me keratinë.Mund të përdorët në lëkura ekstra të thata për të rivendosur elasticitetin dhe butësinë.

## Vaj Jojoba *Kulinar*

Jojoba Culinary Oil

100ml

Vaj jojoba është një vaj ushqimor i pasur me të gjitha llojet e vitaminave dhe mineraleve dhe kjo është arsyeja pse ai ka pamje të dendur fizike. Vaji jojoba futet në kategoritë e vajrave të tjera të famshëm për gatim të tilla si vaj ulliri. Vaj jojoba gjithashtu mund të durojë temperaturat e larta. Përdorimi i tij në industrinë e kuzhinës mbetet i kufizuar për shkak se është e shtrenjtë në krahasim me vajrat e tjerë për shkak të normës së saj të kufizuar të prodhimit. Rekomandohet për ata që ndjekin një dietë pasi nuk ofron asnjë kalori. Nëse vendosni të përdorni vaj jojoba si një vaj gatimi, sigurohuni që jeni duke përdorur versionin organik dhe të pastër të tij për të shmangur konsumimin e papastërtive apo përbërjet e tjera artificiale. Gjithashtu, rekomandohet të merren sasi të vogla dhe të kontrolluara të vajit jojoba për të shmangur steatorrhea.

## Vaj i Farave të Kungullit

Pumpkin seed Oil

100ml

250ml

Përmban Selen dhe Vitamin E që janë të njohura për efektin antioksidativ dhe për mbrojtjen e organizmit ndaj radikaleve të lira.
Përdorimi.
Të përdoret rregullisht një lugë vaj farash kungulli në vaktin e mëngjesit është një dozë e mirë për ta nisur ditën.Për të trajtuar gjëndjen shëndetësore,një lugë çaji vaj farash kungulli në çdo vakt,do të garantojë më shumë përfitime,si rritje e sistemit imunitar,përmirësimin e tonit të lëkurës dhe parandalimin e inflamacioneve.
(Nuk rrekomandohet të përdoret në skuqje) Të hidhet sipër sallaturinave,shoqërues në gatime.
Vaji I farave të kungullit është shumë I ndjeshëm ndaj drites dhe nxehtësisë,ndaj është mirë të ruhet në një shishe vaji në frigorifer,në këtë mënyrë efektet e tij do të zgjasin edhe më shumë.

## Vaj i Farave të Rrushit

Grape Seed Oil

100ml

Vaj i farave të rrushit gjen përdorim në kulinari dhe kozmetikë. Në kulinari përdoret për skuqje, salcat dhe për sallata të ndryshme. Është një përbërës shumë i mirë për bërjen e majonezës. Ruhet në vend shumë të freskët dhe pas hapjes mbahet në frigorifer. Omega-3, Omega-6,Omega-9 janë acide yndyrore që e përbëjnë këtë vaj. Ka përqindje të lartë të vitaminës E që ndihmon në parandalimin e dëmtimit të membranës qelizore. Ndihmon në rritjen e sistemit imunitar dhe qarkullimin e gjakut.
Lufton viruset dhe mikrobet.
Përdorimi: Hidhni pak vaj në dorën tuaj dhe filloni ti bëni masazh lëkurës për 2 minuta. Për pjesët rreth syve lyeni mollëzat e gishtave dhe bëni masazh të lehtë. Ngroheni vajin në banjëmari për të bërë trajtim të ngrohtë për flokët. Ky veprim bëhet 1-2 herë në muaj dhe përshpejton rritjen e tyre.

## Vaj i Farave të Kias

Chia seed Oil

100ml

Vaji i Farave te Kias eshte mire te perdoret direkt, mbi cdo pjate si sallata, supa te ftohta, antipasta, smoothie, kos, apo bollgur. Vaji i Farave te Kias përmbajnë 19 aminoacide dhe të gjitha amino acidet esenciale, përveç taurinës.
Vaji i Farava kia nuk përmban gluten.
Ka përmbajtje të lartë fibrash, që ndihmon tretjen. Përmban 20% Omega-3 duke e bërë një super ushqim për trurin dhe zemrën. Vaji i Farave Kia ka 8 herë më shumë Omega-3 sesa salmoni. Përmban 20% proteina. Është i pasur me antioksidantë (ka 4 herë më shumë sesa boronica). Përmban 5 herë më shumë kalcium sesa qumështi, 7 herë më shumë vitaminë C sesa portokalli, 2 herë më shumë potassium sesa bananja.
Ka një ndikim pozitiv për balancimin e nivelit të glukozës në gjak (duke e bërë një një super ushqim për diabetikët) Është një ushqim i shëndetshëm për lëkurën, flokët dhe thonjtë. Ai eshte i mrekullueshem per lekuren tuaj. Ai zbut lekurat e thata, heq pikat e zeza. Mund te hidhni disa pika ne duar dhe ta masazhoni mbi lekure dhe buze perpara se te dilni nga shtepia.

## Vaj Makadamia

Macadamia Oil

100ml

Vaji makademia përmban 60% acid oleik, 19% acid palmitoleik, 1-3% acid linoleik dhe 1-2% alfa acid linoleik.
Disa varietete përmbajnë dhe omega 6 dhe omega 3. Është vaj i qëndrueshëm për shkak të përmbajtjes së ulët të yndyrave poliinsature.
Përdorimi në kuzhinë: Vaji makademia është ideale për skuqje sepse e ka tempera-turën e vlimit shumë të lartë. Përmban 85% yndyra monoinsature. Ka rezistence në raft 1-2 vjet
Ka temperaturën e vlimit 2100C. Përmban shumë acid oleik (acid yndyror i mirë) sikurse vaji i ullirit. Vetitë antiinflamatore mund të ndihmojnë për kujtesën dhe astmën. Përdorimi në kozmetikë: Përdoret si hidratant për fytyrën. Për pjesën rreth syve për reduktimin dhe eliminimin e rudhave në këtë zonë. Pastrues për makeup. Përdoret për trupin pas dushit. Për flokët: pasi kemi tharë kokën lyejmë duart dhe i bëjmë masazh flokëve në fund por jo pjesës së skalpit.

## Vaj Hudhre

Garlic Oil

20ml

Vaji i hudhrës është mjaft i pasur me minerale, përbërës esencialë dhe vitamina, si fosfor, mangan, magnez, hekur, bakër, kalcium, squfur, vitaminat, C, B1, B2,A. Vlerat Terapeutike: Forcon sistemin imunitar, Lufton diabetin e tipit 2, Është antibakterial, Lufton arteriosklerozën, Është antioksidant, Lufton parazitët në zorrë. Redukton kolesterolin në gjak, Lufton sëmundjet e zemrës, Parandalon dhe kuron tensionin e lartë të gjakut, Stimulon sistemin e qarkullimit të gjakut, Redukton rrezikun e krijimit të trombeve në gjak, Pastron trupin nga toksinat, Ndalon kollën, Ka efekt laksativ, Lufton gripin, Kuron tumoret, Lufton turbekulozin, Parandalon dhe lufton astmën, Relakson dhe fuqizon sistemin nervor, Shkrin gurët ne veshka, Kuron dizanterinë, Lufton sëmundjet e tiroideve, Stimulon sistemin endokrin, Ndalon diarrenë me natyrë bakteriale. Përdorimi: Ky vaj rekomandohet të konsumohet një lugë kafe në mëngjes dhe në mbrëmje. Vaji i hudhrës mund të përzihet me vajra të tjera, si vaji i arrës së kokosit, vaji i ullirit, vaji i farës së zezë, vaji i peshkut, etj., por edhe me lëngje, si lëngje frutash, kos, qumësht etj.Për përdorim të jashtëm, masazhohet vendi me vaj hudhre derisa lëkura ta thithë plotësisht. Për dizanterinë, vaji i hudhrës përdoret në rrugë rektale

## Vaj Rigoni

Organic Oregano Oil

20ml

Vaji i rigonit mund të zbusë simptomat e ftohjes dhe kollës, astmës, alergjive, problemeve me lukthin, por edhe problemeve me lëkurën. Vaji i Rigonit ndihmon në raste të infektimit të traktit respirator, psoriasis, zbokthit dhe herpesit. Vaji i rigonit është i mirë si mjet kundër kërpudhave, siç është "candida albicans", dhe mund të përdoret si antibiotik, sepse me sukses lufton bakterin Stafilokok. Rigoni është i pasur me vitaminë K, hekur, mangan, vitaminë E, kalcium dhe antioksidues të ndryshëm. Përdorimi: Vaji i rigonit duhet të tretet në ujë apo çaj dhe asnjëherë nuk duhet të pihet direkt. Nëse ju dhemb fyti ose jeni ftohur, hidhni disa pika nga ky vaj në ujë të valuar dhe gëndroni mbi avullin që lëshon. Përzieni disa pika vaj rigoni me disa pika vaj ulliri dhe lyeni pjesët problematike të lëkurës. Rigoni mund të shkaktojë reagime alergjike. Nuk rekomandohet për gratë shtatzënat.

## Vaj Eukaliptusi

Eucaliptus Oil

20 ml

Ky vaj njihet si një anti-inflamator i fuqishëm, antispamatik, anti-bakterial, anti-septik, stimulues dhe ka plot cilësi të tjera medicinale.Vaji i eukaliptusit është pa ngjyrë dhe ka një shije dhe aromë të veçantë.Ai nxirret nga gjethet e freskëta. Ky vaj është një ilaç i fuqishëm i cili kuron plagët, ulçerat dhe djegiet, është i efektshëm kundër pickimit të insekteve duke qetësuar zonën e prekur dhe duke e mbrojtur nga aktivititeti mikrobial dhe nga zhvillimi i infeksioneve plagën e hapur. Ndihmon në trajtimin e një sërë problemesh me frymëmarrjen duke përfshirë: kollë, ftohje, rrufë, dhimbje fyti, astma, kongjestion i hudëve, bronkit dhe sinuse. Lodhje mendore: një arsye shumë e rëndësishme që shumë njerëz përdorin vaj eukaliptus është se ai krijon efekt freskues, vaj i eukaliptusit është një stimulues i cili largon lodhjen dhe është i efektshëm në trajtimin e stresit dhe çrregullimeve mendore. Rrit qarkullimin e gjakut nëpër trup duke i relaksuar enët e gjakut dhe duke lejuar të qarkullojë më lehtësisht. Dhimbje të muskujve: fërkoni me vaj eukaliptus spërfaqen e lëkurës, pasi ndihmon në qetësimin e dhimbjeve muskulare.Këshillohet të përdoret në doza të caktuara, nuk lejohet të përdoret nga fëmijët nën moshën 6 vjeç.
Gratë shtatzëna dhe me fëmijë në gji duhet të shmangin përdorimin e këtij vaji.

## Vaj Rozmarine

Organic Rosmary Oil

20 ml

Vaji i rozmarinës është efikas kundër plakjes së lëkurës, rxit prodhimin e kolagjenit dhe ndihmon në parandalimin e formimit të rrudhave. Ai përmban vitaminë E në sasi të mëdha, tre herë më shumë se vaji i ullirit. I pasur me vitaminë A; acide yndyrore esenciale Omega 3 dhe Omega 6 rigjeneruese e antinflamatore; polifenole kundër rrudhave. Përdorimi: Për përmirësimin e kujtesës: miksoni 3 pika vaji rozmarine me ½ lugë çaji vaj kokosi dhe lyeni qafën duke e përhapur nëper qafë dhe shpatulla 1 orë në ditë. Për flokët: hidhni 5 pika vaji rozmarine në skalpin e kokës dhe masazhojeni pas dushit. Për prostatën: miksoni 2 pika vaji rozmarine me 1/2 lugë e vaj kokosi dhe përdoreni poshtë testikujve. Gjithashtu nuk duhet të përdoret tek fëmijët nënmoshën 4 vjeç.

Vajra Bimorë

NERANXI 1994
www.neranxi.al

100% natyralë